



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 19.07.2018

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006,
“PËR MASAT KUNDËR DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, I
NDRYSHUAR**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datave 02.07.2018, 12.07.2018 dhe 19.07.2018 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Vasilika Hysi.

Projektligji u paraqit në komision nga znj.Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale. Mbrojtja e projektligjit, dhënia e shpjegimeve për pyetjet e anëtarëve të Komisionit u bë nga znj.Ardiana Jaku, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe përfaqësues të kësaj ministrie; nga znj. Roven Voda, zëvendësministre e Brendshme dhe përfaqësues të kësaj ministrie, znj. Besa Shahini, zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

2.1 Qëllimi i projektligjit

Projektligji i propozuar për amendimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar ka si qëllim:

- a. Harmonizimin e legjislacionit shqiptar dhe përmbushjen e detyrimeve dhe standarteve të vendosura nga konventa e Këshillit të Europës “*Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*”, ratifikuar me ligjin nr.104, datë 8.11.2012 dhe në mënyrë të veçantë të rekomandimeve për Shqipërinë të Komitetit GREVIO, që vepron në kuadrin e kësaj konvente, të publikuara në muajin dhjetor 2017;
- b. Përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Komiteti CEDAË, në kuadër të raportimit për zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, në vitin 2016;
- c. Përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian dhe zgjidhjen e problemeve të evidentuara nga zbatimi i ligjit në praktikë.

Arritja e barazisë gjinore si dhe minimizimi i dhunës ndaj grave e vajzave si dhe dhunës në marrëdhëniet familjare përbëjnë një prioritet të rëndësishëm, të lidhura ngushtë me proceset integruese të vendit. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë nismash që kanë synuar përmirësimin dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar në këndvështrimin gjinor me instrumentet ndërkombëtare në këtë fushë.

Përpjekjet për të avancuar drejt barazisë gjinore dhe tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, synojnë përmirësimin e mëtejshëm të bashkërendimit me partnerët qeveritarë dhe aktorë të tjerë të interesuar, sidomos me organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në mënyrë specifike për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto çështje, vënien në dispozicion të burimeve njerëzore e financiare për sigurimin e shërbimeve të mjaftueshme e të aksesueshme si dhe ngritjen e mekanizmave monitorues efektivë e të qëndrueshëm.

2.2 Risitë e projektligjit

Ligji “*Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare*”, është miratuar në vitin 2006 dhe ka ndryshuar në vitin 2008¹ dhe 2010². Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) me ligjin nr. 104/2012, datë 08.11.2012. Pra, ligji është miratuar gjashtë vjet më parë dhe nuk adreson të gjitha detyrimet që burojnë nga Konventa e Stambollit.

¹ Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.05.2008.

² Ndryshuar me ligjin Nr. 10329, datë 30.09.2010.

Zbatimi i ligjit në praktikë ka nxjerrë në hap një sërë problematikash që duhet të adresohen nga ligjvënësi.

Projektligji i sjellë nga Këshilli i Ministrave sjell rrishtje e mëposhtme:

- a. Parandalimi dhe reduktimi i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mbrojtja e veçantë e pa diskriminim të asnjë forme për çdo grup në nevojë për mbrojtje;
- b. Përmirësimi i masave mbrojtëse të parashikuara në ligj, në kuadrin e urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrimit të mbrojtjes, duke pasur parasysh, veçanërisht, përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët;
- c. Rritjen e sigurisë që jep Policia e Shtetit nëpërmjet urdhrimit paraprak të mbrojtjes së menjëhershme;
- d. Dhënien e ndihmës ligjore falas, nëpërmjet avokatëve të kualifikuar mbështetur në parashikimet e ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- e. Përcaktimi i afateve të qarta procedurale për regjistrimin e kërkesës për UM-në dhe UMM-në dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore;
- f. Përcaktimi dhe ndarja e qartë e detyrave të organeve përgjegjëse në fushën e masave kundër dhunës në familje.
- g. Sanksionimi i masave mbrojtëse të detyrimit të dhunuesit për pjesëmarrje në shërbimet specifike të rehabilitimit, me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, të droguar ose me probleme të shëndetit mendor.

III. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE DHE REKOMANDIMET E ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E PARANDALIMIT DHE LUFTËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Komisioni i Ligjeve në vlerësimin e projektligjit ka mbajtur parasysh konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria lidhur me parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, rekomandimet e adresuara për Shqipërinë nga mekanizmat monitorues të Konventave, konkretisht CEDAË dhe GREVIO.

Mbrojtja nga dhuna në familje është sanksionuar në disa konventa dhe instrumente ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Në këtë aspekt mund të përmendim: Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 104/2012, datë 08.11.2012, Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e ratifikuar më 11 maj 1994; Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Konventën e OKB për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijëve” dhe protokollet e saj shtesë dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, si dhe Konventën e Këshillit të Europës “Mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

Ratifikimi i këtyre instrumenteve ndërkombëtare dhe detyrimet e vendosura për shtetet anëtare sjellin nevojën për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm për parandalimin e dhunës në familje me standartet ndërkombëtare si dhe me rekomandimet përkatëse të organizmave monitoruese të zbatimit të tyre.

Raporti i GREVIO-s mbi zbatimin e Konventës së Stambollit në Shqipëri, i bërë publik në Dhjetor 2017 bën një vlerësim të masave legjislative dhe të politikave të ndërmarra nga shteti shqiptar gjatë viteve të fundit, për zbatimin e kërkesave të parashikuara në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Në këtë kuadër, GREVIO ka dhënë disa rekomandime për shtetin shqiptar të lidhura me:

- *Garantimin e mbrojtjes së barabartë para ligjit dhe për qasje në mjete juridike të drejta dhe efektive;*
- *Harmonizimin e përkufizimit të dhunës në familje me Konventën dhe adresimin në përputhje me Konventën e Stambollit, të të gjitha formave të dhunës ndaj grave në mënyrë gjithëpërfshirëse;*
- *Angazhimi i burimeve buxhetore të dedikuara për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave nga ministritë tjera të linjës dhe rritja e fondeve për shërbimet sociale, që bashkëtë ofrojnë për të mbështetur viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave;*
- *Zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere veçanërisht për grupet vulnerabël të grave dhe vajzave që trajtojnë nevojat e tyre specifike;*
- *Përfshirja në kurrikulat e të gjitha niveleve të arsimit, të programeve në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave;*
- *Trajnimi i profesionistëve me aftësitë e nevojshme rreth dhunës në familje;*
- *Hartimi dhe zbatimi i programeve të specilizuara për edukimin e autorëve të dhunës në familje me qëllim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e sjelljeve të dhunshme;*
- *Sigurimi i bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet të gjithë mekanizmave referues, dhe pajisja e të gjitha bashkive me një mekanizëm referimi plotësisht funksional;*
- *Ngritja e qendrave të referimit të rasteve kundër dhunës, ku të vihen në dispozicion kontrole mjeko-ligjore, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht;*
- *Sigurimi i shërbimeve mbështetëse të përshtatshme e të specializuara për gratë, të cilat ofrojnë mbështetje të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata për të gjitha viktimat dhe fëmijët e tyre;*
- *Miratimi i masave për të lehtësuar dhe garantuar viktimat e të gjitha formave të dhunës, qasje në kompensim.*
- *Rishikimi i dispozitave ligjore të UMM-ve për të siguruar që në situata të një rreziku të menjëhershëm, UMM-të të lëshohen pa vonesa të panevojshme për të garantuar sigurinë e viktimës dhe përfshirja e vlerësimit të rrezikut, në procedurën e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes.*

- Përfshirja e zbatimit të procedurave të pajtimit gjatë veprimeve të procesit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes;
- T'i sigurohet akses në drejtësi viktimave të dhunës në familje nëpërmjet përfshirjes nga taksat gjyqësore.
- Promovimi i rolit më aktiv të agjencive të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave, duke i nxitur ato të shfrytëzojnë të drejtat e tyre, teksa respektojnë zgjedhjet e informuara të viktimave;
- Sigurimi i ekzekutimit efektiv të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes nga ana e agjencive përgjegjëse, në veçanti përmbaruesve.
- Sigurimin e ndjekjes penale për dhunuesit që shkelin urdhrat e mbrojtjes së menjëhershme dhe urdhrat e mbrojtjes, si dhe të zbatojnë dënimet penale përkatëse;

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave i OKB (CEDAW) në raportin e Katërt Periodik për vendin tonë rekomandon që Pala Shtetërore:

- a. Të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri në zonat rurale dhe të largëta nëpërmjet shërbimit telefonik 24-orësh;
- b. Të forcojë rolin dhe kapacitetet e autoriteteve përkatëse në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- c. Të rrisë numrin dhe kapacitetet e strehave shtetërore, të rrisë financimin e strehave që drejtohen nga organizatat joqeveritare dhe të vërë në funksion mekanizmat për kontraktimin, delegimin ose marrjen e shërbimeve të organizatave jo-qeveritare në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave të të gjitha grave që janë viktime të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë gratë Rome dhe Egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta;
- d. Të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjykatës, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me urdhrat për mbrojtje apo urdhrat për mbrojtje emergjente që janë viktime të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë për këtë qëllim ngritjen e kapaciteteve të personelit gjyqësor, të tillë si përmbaruesit gjyqësor.

Një pjesë e rekomandimeve të mësipërme u adresuan me ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe me ligji 98/2017 “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, me ligjin 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të miturit” që parashikon rregulla specifike për të miturit viktime ose dëshmitarë, përfshirë edhe në rastet e dhunës në familje; me ligjin 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në kodin e Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, që parashikon rregulla të detajuara për pozicionin e viktimës në procesin penal dhe të drejtat e viktimave, përfshirë edhe atyre të dhunës në familje si dhe nga ligji 22/2018 “Për strehimin social”. Një pjesë tjetër e rekomandimeve adresohen nga ky projektligj.

Duke vlerësuar barazinë gjinore, ndalimin e diskriminimit dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave, si kushte të rëndësishme për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, si dhe një ndër objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht objektivi nr. 5/SDG 5, “*Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjithë grave dhe vajzave*” dhe objektivit 16: “*Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet*”, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën nr. 1, datë 04.12.2017, “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”.

Në këtë aspekt pranë Komisionit për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë është ngritur nënkomisioni “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”. Një nga rekomandimet e evidentuara në këtë rezolutë është edhe propozimi për ndryshime ligjore konkrete, të cilat duhet të adresojnë çështjet e mëposhtme:

- a. *rishikimin e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje, duke eliminuar situatën e evidentuar në praktikë, ku dhunuesi dhe viktimat e dhunës, edhe pas vendosjes së masës së mbrojtjes, lejohen të bashkëjetojnë në të njëjtin ambient;*
- b. *forcimin e mekanizmit të mbrojtjes, mbështetjes dhe rehabilitimit të viktimave, me qëllim lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e vijimit të dhunës në familje, duke ofruar plotësimin e të gjitha nevojave për personat e dhunuar në familje, përfshirë asistencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme financiare, punësim, strehim, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale;*
- c. *rishikimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimës dhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme për rastet e rrezikut për jetën, duke mirëpërcaktuar detyrimet e Policisë së Shtetit në këto raste, përcaktimin e personave përgjegjës që marrin përsipër të mbajnë nën kontroll dhunuesin, si dhe aplikimin gjerësisht të mbikëqyrjes elektronike për rastin e dhunuesve brenda familjes;*
- d. *garantimin e mekanizmave rehabilitues për dhunuesin dhe viktimat e dhunës në familje, me fokus të veçantë eliminimin e pasojave të dhunës dhe shmangien e mundësisë së ripërsëritjes së saj në të ardhmen;*
- e. *thjeshtimin e procedurave gjyqësore për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrat të mbrojtjes dhe ndjekjen efikase të ekzekutimit të tij, duke parashikuar në çdo rast vijimin e procesit gjyqësor, pavarësisht tërheqjes së mëvonshme të viktimës, si dhe ngritjen e një mekanizmi eficient të mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve gjyqësore në proceset gjyqësore të dhunës në familje;*
- f. *angazhimin e të gjitha strukturave të shtetit për të ndryshuar mendësitë dhe ndërgjegjësuar publikun mbi pabarazinë dhe stereotipat e dëmshëm gjinorë, që janë baza e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;*

Projektligji adreson të gjashtë çështjet e sipërcituara dhe që janë objekt i veprimtarisë së Nënkomisionit për barazi gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave.

IV. PROCESI I KONSULTIMIT PUBLIK NË KUVEND TË PROJEKTLIGJIT

Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut në kuadër të gjithpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, e dërgoi projektligjin për mendim pranë institucioneve që preken nga fusha e zbatimit të tij si: Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme, Urdhri i Psikologut dhe Urdhri i Punonjësit Social, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Dhoma e Përmbaruesve Gjyqësorë Privat, shoqata dhe unioni i gjyqtarëve etj,

Projektligji i është përcjellë për mendim Shoqatës për Autonominë Vendore dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.

Gjithashtu, projektligji është dërguar për konsultime dhe pranë organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën parandalimit të dhunës në familje: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, UNDP, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Shoqata në Dobi të Gruas, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, UNICEF etj.

Në adresë të komisionit për çështjet ligjore janë paraqitur komente nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nga disa organizata të shoqërisë civile si: UNICEF, Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjimore, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Në tërësinë e tyre komentet e paraqitura kanë vlerësuar shtesat dhe ndryshimet e propozuara në ligjin kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, duke vlerësuar harmonizimin e këtij ligji me instrumentet ndërkombëtare dhe në veçanti me rekomandimet e GREVIO për vendin tonë, duke paraqitur njëkohësisht komente dhe sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të projektligjit ose saktësime në të.

V. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nga relatorja dhe anëtarët e komisioni u theksua rëndësia e miratimit të këtij projektligji i cili reflekton komentet dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtare në këtë fushë, në veçanti rekomandimet e lëna në Raportin e GREVIO-s dhe CEDAW si dhe adreson problematikat e lindura nga zbatimi i ligjit aktual për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, diskutimi në komision u përqëndruara në disa çështje kryesore:

1. Zgjerimi i rrethit të subjekteve që përfshihen në kategorinë e pjestarëve të familjes duke parashikuar mbrojtje të posaçme edhe për personat që janë në lidhje afektive (intime).

Në lidhje me sa më sipër Komisioni vlerësoi këtë propozim në kuadër të detyrimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare si dhe në raportin e GREVIO-s. Përkatësisht në raportin e Komitetit GREVIO, organi që monitoron zbatimin e dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, bëhet referim në marrëdhëniet martesore dhe ato intime, këto të fundit jo detyrimisht të shoqëruara me bashkëjetesë. Ky rregullim mundëson mbrojtjen e një kategorie subjektësh që deri më tani nuk mbroheshin nga ky ligj, por vetëm nga kodi penal.

Konventa e Stambollit e ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 104/2012 i kërkon shteteve anëtare ndërmarrjen e masave të nevojshme legislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë edukimin e autorëve të dhunës në familje, që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes.

Njëkohësisht në përkufizimin e dhunës në familje, Konventa në nenin 3 të saj i referohet jo vetëm bashkëshortëve dhe ish-bashkëshortëve por edhe partnerëve.

Deklarata e Pekinit dhe Plani i Veprimit u bëjnë thirrje shteteve të marrin masa të integruara për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe në mënyrë specifike për të ushtruar vigjilencë e duhur për të parandaluar e veprave të dhunës kundër grave.

Në këtë aspekt, Komisioni vlerësoi që përfshirja në kategorinë e pjestarëve të familjes edhe të personave që janë ose kanë qënë në marrëdhënie intime jo vetëm adreson problematikat aktuale, por edhe reflekton standartet ndërkombëtare me qëllim final mbrojtjen e jetës dhe integritetit të viktimave të dhunës. Për të qartësuar zbatimin e këtij propozimi u përfshi edhe një përkufizim i cili jep nocionin e marrëdhënies intime, si marrëdhënia ndërpersonale e cila përfshin intimitete fizik dhe emocional. Ky koncept përfshin marrëdhënien ndërmjet dy personave që i përkasin gjinive të ndryshme ose të personave të të njëjtës gjini.

2. Urdhri paraprak i menjëhershëm i mbrojtjes

Përfshirja e masave të reagimit të menjëhershëm ndaj fenomeneve të dhunës nëpërmjet parashikimit të urdhrit paraprak të mbrojtjes së menjëhershme të lëshuar nga Policia e Shtetit, përbën një risi të këtij projektligji. Nga anëtarët e Komisionit u vlerësua se dhënia e kompetencave Policisë së Shtetit për të vepruar menjëherë në rastet kur dhuna paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes do t'i shërbejë pozitivisht parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Me qëllim sigurimin e proporcionalitetit ndërmjet qëllimit që synohet të arrihet ndërpërmjet kësaj mase që është mbrojtja e viktimave, respektimit të të drejtave të dhunuesit dhe respektimit të parimit të ligjshmërisë, Komisioni i Ligjeve pas konsultimeve dhe diskutimeve me ministrinë propozuese, Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Drejtësisë, miratoi disa ndryshime në këtë dispozitë të cilat synojnë përcaktimin e qartë të masave që mund të marrë Policia e Shtetit nëpërmjet urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

Ndryshimet e miratuara në komision synojnë të garantojnë balancën ndërmjet mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik të viktimës së dhunës në familje dhe fëmijëve nga njëra anë si dhe respektimin e të drejtave të dhunuesit të garantuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, nga ana tjetër.

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, parashikohet të nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, duke bashkëpunuar në çdo rast me ministrinë përgjegjëse për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje.

3. Përputhshmëria e parashikimeve të projektligjit me Kodin e Procedurës Civile

Komisioni i ligjeve analizoi me kujdes të veçantë përputhshmërinë me dispozitat e KPC të parashikimit sipas të cilit, moskonfirmimi i njoftimit të palëve nuk pengon gjykatën të vazhdojë gjykimin dhe të vendosë për një nga urdhrat e mbrojtjes, komisioni vlerësoi se ky propozim jo vetëm i shërben sigurimit të të drejtave të viktimës së dhunës në familje, por gjen mbështetje edhe në nenin 21 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se: *“kur ligji e lejon dhe rrethanat e çështjes diktojnë marrjen e një vendimi gjyqësor, pavarësisht nga dijenia e një pale, kjo e fundit ka të drejtën të ankohet në rrugë gjyqësore ndaj vendimit të dhënë”*. Në këtë aspekt komisioni vlerësoi të mos reflektoj sugjerimin e komisionit të Sigurisë për heqjen e këtij propozimi.

Për të siguruar harmonizimin e plotë të këtij parashikimi me dispozitat e KPC, komisioni i Ligjeve propozoi dhe miratoi riformulimin e tij duke marrë në konsideratë kërkesat e nenit 21 të KPC.

4. Sanksionet administrative në rast të mosvënies në dispozicion të dokumentacionit nga organet përgjegjëse

Një çështje e diskutuar në komision lidhet me sanksionet administrative të propozuara në rastet e moslëshimit të dokumentacionit të nevojshëm për të provuar ushtrimin e dhunës në familje, nga autoritetet përgjegjëse. Duke marrë në konsideratë:

- a) Nevojën për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të viktimës;
- b) Nevojën për të shmangur burokracitë e panevojshme; dhe

- c) Domosdoshmërinë e adresimit të rasteve të pamundësisë së viktimës për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për të vërtetimin e dhunës në familje, gjatë gjykimit të kërkesës për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes,

Komisioni vendosi riformulimin e këtij propozimi duke:

- Përcaktuar detyrimin e organit administrativ për lëshimin e dokumentacionit mbështetur në urdhrin e gjykatës.
- Parashikuar se rastet e moslëshimit të dokumentacionit do të përbëjnë shkak për fillimin e ecurisë disiplinore, ndaj personit përgjegjës.

Nëpërmjet riformulimit të këtij propozimi është adresuar edhe sugjerimi i dhënë nga Komisioni i Sigurisë.

VI. PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE TË MIRATUARA NË KOMISION

Ndryshimet dhe shtesat kryesore të propozuara në raport me nismën e propozuar nga Këshilli i Ministrave, nga relatorja, deputetë të komisionit, nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare, nga grupet e konsultuara, qofshin institucione të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, organizata vendase dhe ndërkombëtare u diskutuan gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Komisionin e Ligjeve. Para miratimit të tyre, ato u dakordësuan ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme.

Shtesa dhe ndryshimet e miratuara gjatë diskutimit të projektligjit në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë vijon:

1. Reflektimi i sugjerimeve të paraqitura nga Shkolla e Magjistraturës dhe organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht të Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, përsa i takon harmonizimit të disa përkufizimeve me parashikimet e Kodit të Familjes;
2. Shtimi i garancive ligjore për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, në kuadër të hamonizimit të këtij projektligji me parashikimet e legjislacionit në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, bazuar në sugjerimet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Shkollës së Magjistraturës dhe organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht të Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore;
3. Riformulimi tërësor të dispozitës që parashikon subjektet përfituese nga ky ligj me qëllim harmonizimin me legjislacionin në fuqi për të huajt dhe legjislacionin në fuqi për azilin, duke mbajtur në konsideratë propozimet përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme;

4. Parashikimi i detyrimit të autoritetit kryesor përgjegjës për të raportuar përpara komisionit përgjegjës parlamentar/ nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës, bazuar në sugjerimet e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Ky rregullim reflekton edhe standardet ndërkombëtare të parashikuara në konventat lidhur me rolin e parlamentarëve në adresimin e çështjeve gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve dhe është në përmbushje të Rregullores së Kuvendit dhe angazhimeve të marra nga Kuvendi me rezolutave të miratuara prej tij;
5. Parashikimi i një mbrojtje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara në harmoni me konceptin e përshtatjes së arsyeshme, bazuar në Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, sipas sugjerimeve të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Shkollës së Magjistraturës dhe Fondacionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
6. Qartësimi dhe saktësimin i kompetencave të autoritetit kryesor përgjegjës për mbikqyrjen e shërbimit në qendren kombëtare të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje dhe për koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njesive të vetëqeverisjes vendore, bazuar në sugjerimet e paraqitura nga organizata të shoqërisë civile dhe dakortësuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale;
7. Reflektimi i sugjerimeve të Komisionit për Sigurinë Kombëtare për sa i takon detyrave të lidhura me ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike;
8. Përshtatja dhe hamonizimi i detyrave të caktuara për ministrinë përgjegjëse për drejtësinë me parashikimet e bëra në legjislacionin në fuqi për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, nëpërmjet parashikimit të bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe organe të tjera në përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje. Përmirësimet mbajnë parasysh paketën e ligjeve të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi dhe kompetencat e reja që kanë organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe u dakortësuan me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë;
9. Saktësimi i përgjegjësisë dhe shmangia e mbivendosjes të detyrave të autoriteteve përgjegjëse, vecanërisht duke u mbështetur në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në përcaktimet e ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, bazuar në propozimet e bëra nga UNICEF, relatorja, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe të Ministrisë së Drejtësisë;
10. Përfshirja e shërbimit të provës, në monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes së bashku me njësitë të vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbikqyrjen elektronike të personave të cilëve iu kufizohet liria, bazuar në sugjerimet e organizatave të shoqërisë civile;

11. Parashikimin si detyrë të njërive të vetqeverisjes të vendore atë të marrjes së masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqendrimit të viktimës, bazuar në sugjerimin e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, relatores, të organizatave të shoqërisë civile, dhe UNICEF;
12. Parashikimi i mundësisë së bashkëpunimit të bashkive fqinje në ngritjen e qendrave të përbashkëta të shërbimit kundër dhunës në familje, me qëllim uljen e kostos financiare që duhet të përballojnë njësitë vendore, bazuar në sugjerimet e UNICEF, relatores dhe deputetes K. Bushka.
13. Specifikimi i masave që shërbejnë si garanci për mbrojtjen e viktimave bazuar në sugjerimin e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe sugjerimin e organizatave të shoqërisë civile;
14. Reformulimi i dispozitës që trajton urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme me qëllim sigurimin e balancës së duhur ndërmjet sigurimit të mbrojtjes së viktimës, respektimit të të drejtave të dhunuesit dhe shmangies së çdo mundësie për abuzim nga ana e autoriteteve policiore, bazuar në sugjerimet e Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë dispozitë janë reflektuar edhe sugjerimet e Komisionit për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për thirrjen në seancën gjyqësore të vlerësimit të masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme edhe të koordinatorit vendor dhe punonjësit të policisë së shtetit. Reformulimi është diskutuar gjërësisht dhe është riformuluar në bashkëpunim me të të gjithë përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të këtij projektligji;
15. Harmonizimi i projektligjit me parashikimet e ligjit të miratuar rishtazi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe reflektimin e sugjerimeve të Komisionit për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në dispozitën që trajton kërkesë-padinë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm dhe urdhrit të mbrojtjes;
16. Harmonizimi i projektligjit me parashikimet e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për sa i takon saktësimin e gjykatës kompetente për lëshimin e urdhrave mbrojtjes në rastin e dhunës në familje;
17. Parashikimi i një neni të veçantë për sa i takon nxjerrjes së akteve nënligjore dhe afatit të miratimit të tyre në këndvështrim të nenit 118 të Kushtetutës.

VI. Projektligji, nevoja për mbështetje në zbatimin e tij

Projektligji i miratuar në komisionin e ligjeve përbën një bazë ligjore të mirë për parandalimin dhe kufizimin e dhunës në familje. Riset e tij të parashikuara në ligj kërkojnë marrjen e një sërë masash të karakterit organizativ, të rishikimit të praktikave dhe

udhëzuesve të punës, të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, koordinim të mirë të punës mes institucioneve në nivel vendor dhe qendror, forcim të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mbështetje financiare të nevojshme. Pjesë e saj e propozimeve është parashikimi i një periudhe të mjaftueshme për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij projektligji dhe informimin e institucioneve, të punonjësve të praktikës dhe publikut.

Gjithashtu, në cilësinë e relatores së projektligjit, deputetja V.Hysi sugjeron që Qendra e Botimeve Zyrtare të botojë variantin e ligjit të plotë dhe të konsoliduar, kërkesë kjo e nenit 14 të ligjit nr. 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e qendrës së botimeve zyrtare” për arkivin elektronik të akteve që kërkon botimin e përditësuar të akteve të ndryshuara dhe të miratuara.

VII. Përfundime

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

1. **Në aspektin ligjor**, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
2. **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, sipas propozimeve, me votat e anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

RELATORE

KRYETAR

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr.____/2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9669,
DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET
FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje,

duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar si dhe të çdo individ, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3, të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje.”

Neni 2

Në pikën 1 shkronja “c” të nenit 2 fjala “gjqësor” zëvendësohet me togfjalëshin “sistemit gjyqësor”

Neni 3

Neni 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

Neni 3 Përkufizimet

Në kuptim të këtij ligji, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjestarëve të familjes të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.
3. “Dhunues/e” është personi i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.
4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi ‘i mitur’, i përdorur në këtë ligj, ka të njëjtin kuptim.
5. “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të Dhunes në Familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

6 “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.

7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

- a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish–bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
- b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;
- c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit;
- ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/thjeshtren edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;
- d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
- dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;
- e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
- “ë) personat, të cilët janë ose kanë qënë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;
- f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.”.

8. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional.

9. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

10. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit masa për rehabilitimin e dhunuesit;

11. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate.

12. “ Urdhri për Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”, është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1 të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet

përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”

Neni 4

1. Pas nenit 3 shtohet neni 3/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1 Legjislacioni i zbatueshëm

1. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit) dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe nenin 13/1, të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriterëve të parashikuar në këtë ligj.”.

Neni 5

Neni 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 4 Subjektet

1. Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjitha subjektet e përcaktuar në nenin 3, pika 7 e këtij ligji që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekte që mbrohen nga ky ligj janë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi për të huajt që përfshihen në kategorinë e subjekteve të parashikuara në pikën 7 të nenit 3 të këtij ligji.”

Neni 6

Neni 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 5 Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

- a) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
- b) Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- c) Ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
- ç) Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- d) Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit;
- dh) Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional
- e) Njësitë e vetqeverisjes vendore.

3. Lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, ndryshon nëse njëri prej tyre merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet në fushën përkatëse.”.

Neni 7

Në nenin 6 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Shkronjat “c”, “ç” dhe “d” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet

familjare, përfshi këtu asistencë financiare si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, Shkollën e Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhet me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore;

d) bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare.

2. Shkronja “g” dhe “gj” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“g) harton politikat dhe mbikëqyr marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve;

gj) Ofrimin dhe mbikqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje.

3. Pas shkronjës “gj” shtohen shkronja “h” dhe “i”, me këtë përmbajtje:

h) hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre”.

“i) Koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetqeverisjes vendore.

Neni 8

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja hyrëse e pikës 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) trajnimin e punonjësve të policisë së shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;”.

c) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje;

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetqeverisjes vendore.”.

b) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje;

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:

- a) organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve sociale në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;
- b) monitoron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj nga ana e personelit mjekësor;
- c) parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktima trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja hyrëse e pikës 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra:”

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbaruesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;”.

c) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1”, me këtë përmbajtje:

“b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;”.

ç) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;”.

d) Pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç”, “d”, “dh”, me këtë përmbajtje:

ç) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;

d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;

dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

5. Në pikën 3/1, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja hyrëse e pikës 3/1 ndryshohet si më poshtë:

“Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe ministria përgjegjëse për arsimin profesional sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimë, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.”.

6. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Njësitë e vetqeverisjes vendore bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji kanë këto detyra:

a) Angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) Ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

c) Ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin, dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) Marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) Marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqendrimit të viktimës.

dh) Bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetqeverisjen vendore.

7. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

Neni 9

Pas neni 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1
Garancia për mbrojtjen

1. Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit, drejtohet viktimë garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.”.

2. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurtë ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Neni 10

Në pikën 3, të nenit 8, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) Hartimit nga punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së vetqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psiko-sociale të viktimës.

Neni 11

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shkronjat “j” “k” dhe “m” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“j) duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personat me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi.

k) duke urdhëruar organet kompetente, shërbimet sociale të njësive përkatëse të vetqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë

shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psiko-sociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

m) duke urdhëruar dhunuesin/en, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi psiko-sociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi/ja nuk merr pjesë në program, atëherë, me kërkesë të mbledhjes *ad-hoc* të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13, i këtij ligji, zbatohen dispozitat e Kodit Penal, për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes.”.

2. Pas shkronjës “m” shtohet shkronja “m/1”, me këtë përmbajtje:

“m/1) duke urdhëruar të paditurin ose dhunuesin/en nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi, pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorë ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkologjisë ose shërbime të toksikologjisë. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit vënë në dijeni koordinatorin vendor pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij;

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, deri sa nuk cënohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

3/2. Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të

zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.”.

Neni 12

Në pikën 1 të nenit 11, shprehja “përmban masat e mësipërme”, zëvendësohet me shprehjen “përmban masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji”.

Neni 13

Në pikën 1 të nenit 12 shprehja “gjykata e rrethit gjyqësor, seksion familjar”, zëvendësohet me shprehjen “gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë”.

Neni 14

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1, me këtë përmbajtje:

Neni 13/1

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

1. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës/ave dhe për ndalimin e dhunës.
2. Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme:
 - a) urdhërimi i dhunuesin/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;
 - b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;
 - c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
 - ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

- d) urdhërimi i një punonjësi të policisë së shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”;
 - dh) urdhërimin e një punonjësi policie që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;
 - e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.
3. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe Ministrit përgjegjës çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.
- Një kopje e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë, koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.
4. Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
5. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesë padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.
6. Të drejtën për të kërkuar vlerësimin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës e ka edhe viktimja dhe subjektet e parashikuara nga neni 13 pika 3 e këtij ligji, brenda 48 orëve, nga dita e lëshimit të tij.
7. Gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:
- a. Vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;
 - b. Anulimin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.
8. Gjykata, për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.

Neni 15

Në nenin 14 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pikat 3, 4 e 5, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Për hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike dytësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

4. Kërkuuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga:

- a. pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- b. detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- c. pagimi i akteve të ekspertimit psiko-social, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.

Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.

5. Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata sipas nevojës mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Gjykata në vendimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes vendos edhe për rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.”

Neni 16

Në nenin 15 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalja e fundit e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

Në rastet kur kërkuuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë paragraf, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e

të drejtave të viktimës, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Mos lëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përbën shkak për fillimin e ecuresë disiplinore, ndaj personit përgjegjës bazuar në dispozitat e legjislacionit të posaçëm.”

Neni 17

Pika 1, e nenit 16, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Gjkata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e regjistrimit të kërkesës.”.

Neni 18

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Gjkata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtimi ose ndërmjetësim.”.

2. Në pikën 3 shkronja “ç”, shfuqizohet.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.”

Neni 19

Pika 1, e nenit 20, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16, të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata: ”.

Neni 20

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 shfuqizohet.
2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim. Ankimi paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve, nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni. Gjykata e Apelit vendos, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankim nga viktima.

Neni 21

Në nenin 23 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e policisë së shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, si më poshtë vijon:

“3/1. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetqeverisjes vendore monitoron respektimin e Urdhrit të Mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e

Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.”.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes.”.

4. Pikat 2 dhe 5 shfuqizohen.

Neni 22

Kudo në ligj, togfjalëshi “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB)” zëvendësohet me togfjalëshin “ministra përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje”.

Neni 23

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Ministri përgjegjës për shëndetësinë që, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të Nenit 7, pika 2.1, shkronja “c”, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e Rendit dhe të Sigurisë Publike dhe ministri përgjegjës çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje që, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të Nenit 7, pika 1 shkronja “b/1” dhe nenit 13/1 pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për drejtësinë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor që brenda katër muajve nga krijimi i këtij të fundit, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim Nenit 7 pika 3 shkronja “ç”, të këtij ligji.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI